



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 402/24 Dt. 04.07.2024



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren

Prizren Belediyesi

**Procesverbali për mbajtjen e takimit të parë publik me qytetarë për raportin
për punën gjashtë (6) mujore për vitin 2024**

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna me theks neni 30-Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Publikimi në uebfaqe të komunës

Me 14.06.2024

Njoftimi në gjuhë Shqipe, Boshnjake, Turke, Rome dhe Angleze: <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/06/Njoftim-per-organizimin-e-takimit-te-pare-publik-me-qytetare.pdf>

Njoftimi si lajm: <https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-takimit-te-pare-publik-me-qytetare-pe-punen-e-kryetarit-shaqir-totaj-per-gjashte-6-mujorin-e-pare-te-vitit-2024/>

Publikimi në Platformën për Konsultime Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42496>

Facebooku i komunës:

<https://www.facebook.com/share/p/pCraufWRjmp2VqKX/?mibextid=oFDknk>

Me 28.06.2024, është mbajtur takimi publik me qytetarë.

Lajmi për mbajtjen e konsultimit publik është publikuar në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/prizren/news/kryetari-totaj-mbajti-takimin-e-pare-publik-me-qytetare/>

Lajmi është publikuar edhe në facebookun e komunës:

<https://www.facebook.com/share/p/GvIVdGs4L5WagNAz/?mibextid=oFDknk>

Në këtë vegëz: <https://www.facebook.com/share/v/YkYKKcNqRNQMhMtJ/?mibextid=oFDknk> mund ta gjeni video incizimin për mbajtjen e takimit.

Të interesuarit komentet, sugjerimet dhe kërkesat kanë pasur mundsi ti dërgojnë deri me 27.06.2024 në këto emaila: Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Takimi ka filluar në orën: 10:15

Ymer Berisha, Udhëheqës i Njësisë së Komunikimit me Publikun-Qytetarë të nderuar, kam kënaqësinë e veçantë që të hap takimin e parë publik me qyfterë, kryetari i komunës, Shaqir Totaj si zakonisht ka kërkuar që nga gjithë stafit politike dhe ai administrativ i komunës së Prizrenit, fokusin kryesor të kemi qytetarin, kërkesën e tij, mënyrën e jetesës. Çka mund të bëjmë mirë sa mund të bashkëpunojë më shumë e kështu me radhë.

Departamenti që udhëheqë unë normalisht e ruan cilësinë ligjore të aktiviteteve të kryetarit komunës dhe komunës në përgjithësi, në mënyrë që së bashku me qytetarët jemi brenda afateve të rregullta ligjore dhe tashmë duke kaluar në secilën ditë. Kemi filluar që ti numëroj argumentet vepruese përmes projekteve, qoftë në zona rurale, qoftë në zonën urbane.

Unë meqë një kohë të gjatë jam komunën e Prizrenit, kam evidentuar qeverisje, e cila ka grumbulluar probleme dhe zgjidhjet kanë munguar. Kam kënaqësinë që ta njoftoi opinionin publik edhe përmes mjeteve të informimit se Qeverisja e tanishme është në funksion të zgjidhjes së problemeve. Nëse doni argument me pas e keni atë shtëpinë 20 vjeçare, e cila ka bërë pengesë dhe se gjatë kësaj qeverisje, ajo shtëpi është eliminuar nga trasta e rrugës, rruga ju ka kthyer qytetarëve dhe zhvillohet komunikacioni edhe me efikasitet dhe me cilësi të lartë.

Kemi pastaj edhe probleme tjera, kemi edhe 1 argument të fortë Sheshi i shatërvanit në shumë qeverisje janë hap kanalizime, gropa dhe kthimi i kubëzave. Reshjet e shiut kanë nxjerrë të vërtetën atyre punimeve dhe tash kjo qeverisje normalisht që ka hyrë në krenarinë e qytetit të Prizrenit, në identifikimin e tij dhe në forcimin e kërkesës që na kemi, 1 kërkesë pending në unesco qyteti i Prizrenit të trajtohet nga unesco dhe të merr statusi i mbrojtur nga unesco dhe sheshi i shatërvanit është 1 mundësi shumë e madhe që të shkojnë në këtë drejtim.

Vendimmarrja e komunës së Prizrenit nga kryetari Totaj është kërkuar që të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe autorësia e kësaj vendimmarrje të jetë më shumë qytetarëve dhe ligjeve. Ose rregullore të punës në të cilat komunat, drejtorët dhe të gjithë të punësuarit në komunë, përmes tyre ligjet përmes tyre rregulloreve. E fundit që pa u zgjatur në respekt të kohës, kryetari ka kërkuar nga ne që të jemi komunikative me shqiptarët për arsye se komunikimi arrit besimin e ndërsjellë dhe nëse vendimmarrja e kryetarit Totaj e përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve në komunën e Prizrenit, rezultatet e tilla na ofrojnë si ky takim i parë publik.

Do të ftojme pas fjalës hapëse time, kryetarin e komunës të bëjë raportin e punës 6 mujore komunës së Prizrenit për vitin 2024, pastaj fjala do kalojë te ju të nderuar të pranishëm. Me ngritje dore emër mbiemër ka përfaqësoni. Kjo na vyen për evidentim në procesverbal se do të shkruhet me emrin ja me çfarë kemi propozuar ose keni kërkuar ose çfarë keni bashkëbiseduar me kryetarin e komunës. Edhe jemi duke u munduar që ta rregullojmë memorien institucionale në vitin 2024 ta zamë në qershor më 20 qershor, secili individualisht kur thoni prezantojmë këtë pjesë të komunitetit, do të regjistrohet në procesverbal, do të publikohet në faqe dhe qindra vite mbraja, nëse dikush nga familja juaj ose eventualisht kushdo të interesuar mund ti kthehet kësaj memorie institucionale dhe shih kontributin e paraardhësve të tyre për të mirën e qytetit në përgjithësi.

Kryetari i Komunës, Shaqir Totaj-Faleminderit për këtë hapje të takimit, sëpari i përshëndes të pranishme dhe i falënderoj që kanë ardhur në takim për të dëgjuar në raportin e që do e bëjë sot. E kemi 1 raport që ka 35 faqe, por ky raport është i publikuar edhe në webfaqen zyrtare. Kështu që unë nuk do ta lexojë komplet, pasi që mund të na merr shumë kohë, më shumë do të kenë kohë me bisedë interaktive, për shkak se jam i sigurt që keni nevojë me bë pyetje dhe shpjegime, por do të jap 1 raportim të përgjithshëm të punëve që janë bo.

Por para se me filluar me raportin për këtë periudhën prej janarit deri në mes të qershorit që përfshin ky raport, me ju njoftua se i kemi 2 vlerësime shumë të mira, komuna e Prizrenit është komuna më transparente me pik të njëjta me 3 komuna tjera e që ka të bëjë me transparencë komunale, qoftë 1 indikator i mirë i performancës, po ashtu edhe para disa ditësh publikua raporti i auditorit përgjithshëm, i cili ka dalë raporti mirë prej komunave të mëdhaja.

Përzënia e ka raportit ma t'mirë të auditorit jashtëm që po ashtu është 1 indikator shumë i rëndësishëm i performancës financiare. Vlerësimi i performancës së ministrisë së administrimit të pushtetit lokal po ashtu është në proces edhe ai do të jetë sipas gjitha gjasave i mirë se vitin e kaluar ka pasur progres, por sivjet do të ketë progres. Edhe jemi në proces përgatitjes së përqindjes.

Mbajtja e premtimeve elektorale që e kemi dhënë shikohet nga instituti GAP edhe aty sipas të gjitha gjasave deri më tani jemi diku rreth 60% të premtimeve që kemi dhënë janë përmbushur. Ata nuk e tha me fjalë, por të del raporti i GAP dhe do të jetë i qasshëm për secilin periudhe, përndryshe për përmirësimin e jetës dhe kualiteti i jetës qytetarëve të territorit, komunës, prodhimit të ketë banorëve komplet nëpër qytet nëpër fshat.

Vazhdojmë t'i takojmë qytetarët, OJQ-të, mediat, institucionet publike e ambasadat. Me të gjithë kemi krijuar marrëdhënie të mira dhe korrekte. Gjatë gjithë këtyre viteve kemi pritur OJQ, ambasadorë dhe përfaqësues të misioneve diplomatike me të cilët kemi zhvilluar projekte dhe kemi bashkëpunim për ta zhvilluar kulturën, sportin, ambientin dhe projekte në sfera të ndryshme.

Kemi pasur takime dhe pritje në zyre të shumë organizatave joqeveritare, personaliteteve të shquara, të institucioneve vendore e të huaja dhe delegacione të ndryshme vendore, ndërkombëtare e diplomatike.

Përveç takimeve të lartcekura, gjithashtu janë mbajtur edhe shumë takime me deputetë, OJQ dhe shoqata të ndryshme, klube sportive, takime me KFOR-in, pjesëmarrje në tryeza me ftesë nga niveli qendror apo lokal, përrurime të investimeve kapitale në Prizren, pjesëmarrje në shumë aktivitete, takime individuale me qytetarë. Kemi nënshkruar 14 memorandume të bashkëpunimit me institucione të ndryshme.

Zyra për Integritet Evropian.

Gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2024 është bërë sigurimi i implementimit për zbatimin e obligimeve të Komunës nga Agjenda Evropiane për veprimet që ndërlidhen me komunën dhe raportimi sipas kërkesave të MAPL-së.

Sipas kërkesës së MAPL-së janë mbledhur të gjitha informatat e kërkuara nga secila drejtori në lidhje me zbatimin e obligimeve të komunës nga Agjenda Evropiane 2024 për PKZMSA (Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit).

Pjesëmarrja në trajnimin “Parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative” i organizuar nga IKAP - GIZ dhe certifikimi.

Zyra për Informim

Njësia për Komunikim me Publikun, gjatë periudhës raportuese gjashtë mujore ka lekturuar, përkthyer në gjuhët zyrtare (Turqisht, Boshnjakish) dhe ka publikuar në ueb faqe të komunës të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit.

Vendimet e kryetarit janë publikuar në vegëzën vijuese: <https://kk.rks.gov.net/prizren/category/vendimet-e-kryetarit/>

Vendimet e Kuvendit të Komunës i gjeni të bashkëlidhura në vegëzën: <https://kk.rks.gov.net/prizren/category/vendimetregullore/vendimet/>

Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi pranuar 74 kërkesa për Qasje në Dokumente Publike, ku të gjitha kërkesave u është dhënë përgjigje dhe duke ofruar dokumentet në afate ligjore.

Zyra Ligjore

Gjatë kësaj periudhe janë hartuar dhe janë proceduar për nënshkrim te Zyra e Kryetarit të Komunës në total 282 vendime 9 autorizime deri me 11.06.2024:

Spektori për Çështje Pronëso-ro-Juridike

Në periudhën Janar-Qershor 2024, Spektori për Çështje Pronëso-ro-Juridike ka pranuar gjithsejtë - 303 lëndë, prej të cilave në afatin e paraparë ligjor janë shqyrtuar dhe aprovuar 271 lëndë, janë refuzuar 23 lëndë, ndërsa 9 lëndë janë në procedurë e sipër.

Zyra e Auditimit

Nga katër (4) detyra audituese dhe një (1) detyrë për përcjelljen e zbatueshmërisë së rekomandimeve, të planifikuara për periudhën janar-qershor 2024, deri në kohën e përgatitjes së këtij raportit (10 qershor), janë finalizuar katër (4) raporte dhe një (1) detyrë audituese është në process.

Janë realizuar këto detyra audituese:

Raporti mbi rishikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NjAB për vitin 2023, është dhënë një (1) rekomandim;

Zbatimin e procedurave lidhur me identifikimin evidentimin, klasifikimin, barazimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së komunës në libra e pasurisë (në DBF), janë dhënë tri (3) rekomandime; Rregullsitë e procesit të planifikimit dhe inkasimi i të hyrave nga bashkëpagesat (participimi) në Drejtorinë e Shëndetësisë, është dhënë një (1) rekomandim;

Rregullsitë lidhur me kalkulimin e detyrimeve dhe grumbullimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe tokë, janë dhënë dy (2) rekomandime;

Menaxhimi i shpenzimeve për mallra, shërbime dhe të komunalive në Administratën e Komunale, **është në proces.**

Gjithashtu në kuadër të objektivave të përcaktuara, NjAB ka realizuar edhe këto aktivitete audituese:

Bashkërendimi i auditimit me ekipin e ZKA (Zyra Kombëtare e Auditimit) për periudhat që kanë audituar në Komunën tonë (shkurt – mars 2024) dhe koordinimi i aktivitete lidhur me draftraportin e ZKA-së;

Raportet vjetore për Kryetarin e Komunës, Komitetin e Auditimit dhe NjQHAB/MFPT:

Periudha e raportimit: Raporti vjetor për vitin 2023 (koha e raportimit, janar 2024).

Zyra e Burimeve Njerëzore

Nga periudha 01.01.2024 deri më 06.06.2024 ka pranuar (treqind e nëntëdhjetë e dy) 392 kërkesa, të cilat janë shqyrtuar dhe një pjesë e tyre janë në proces sipas procedurës.

Shkresat dhe komunikimet elektronike janë 763.

Numri i konkurseve të shpallura për nëpunës të shërbimit civil për periudhën e raportimit është 14, prej të cilëve: 14 janë shpallur për pranim në shërbimin civil, ku 4 prej tyre kanë përfunduar me sukses dhe janë plotësuar me staf, 2 të dështuara pa kandidatë të suksesshëm dhe 8 janë në procedurë.

Numri i konkurseve të shpallura për nëpunës të shërbimit publik është 3 me gjithsej 20 pozita prej të cilëve: Në Shëndetësi: 3 konkurse me 20 pozita, prej tyre: 2 konkurse me 14 pozita kanë përfunduar me sukses, 1 konkurs me 6 pozita në procedurë;

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Ngritja e mirëqenies të komuniteteve minoritare/Shpërndarja e pakove ushqimore-higjienike - 48 familje;

Kthimi i personave të zhvendosur nga regjioni;

Shpërndarja e granteve me përfaqësuesin e IOM-it, ZKKK-ja ka marrë pjesë gjatë shërndarjes së granteve për përkrahjen e bizneseve. Gjithsejtë kanë përfituar 5 familje boshnjake dhe dy raste nga komuniteti rom.

Zyra e Prokurimit

Deri më 13. 06 2024 janë shpallur tenderë për punë, shërbime dhe furnizime, të vlerave të vogla, të mesme dhe të mëdha - gjithsejtë 100 projekte; Janë nënshkruar gjithsejtë 95 kontrata të vlerave të vogla, të mesme dhe të mëdha; Janë nënshkruar 2 aneks kontrata për kontratat bazë të vitit të kaluar; Janë në proces të hapjes dhe vlerësimit edhe 35 lëndë; Në proces të ankimimit për vitin 2020 deri në këtë datë janë gjithsejtë 7 lëndë.

Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave

Spektori për Buxhet dhe Thesar gjatë periudhës Janar – 10 Qershor 2024 ka ekzekutuar pagesat për 1,627 lëndë, po ashtu ka bërë zotimin e 794 lëndëve. Po në të njëjtën kohë për 1.035 lëndë ka bërë pranimin e mallit në sistem dhe ka bërë aprovimin e lëndëve për mjetet e zotura për 1.627 lëndë.

Për vitin 2024 janë planifikuar të hyra 10,193,294.00 € kurse për këtë periudhë janë mbledhur të hyra vetanake 4,231,823.32 € apo 41.52 % nga planifikimi.

Sektori i Tatimit në Pronë për periudhën Janar – 10 Qershor 2024: janë shpërndarë 34,008 fatura për tatimpaguesit. Nga ky sektor janë realizuar të hyra në shumën prej 1.360.945.51€, janë regjistruar 859 objekte të reja dhe janë verifikuar 673 objekte ekzistuese. Po ashtu, ky sektor ka pranuar dhe shqyrtuar 563 ankesa për pronën e paluajtshme.

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Drejtoria për Shërbime Publike gjatë vitit 2024 bazuar në planifikimin buxhetor si dhe planit të punës, ka paraparë shumë projekte të reja përveç atyre ekzistuese që janë në implementim. Rreth 50 projekte që vazhdojnë nga vitet paraprake.

Për për Drejtorinë e Shërbimeve Publike janë planifikuar për Investime Kapitale 12,710,000.00€ nga të cilat mjete nga granti qeveritar janë 10,610,000.00 € dhe 2,100,000.00 € nga të hyrat vetanake.

Në kategorinë Mallra dhe Shërbime në Drejtorinë e Shërbimeve Publike është paraparë buxhet në vlerë prej 3,089,662.00€

Përveç këtij buxheti nga të hyrat e bartuara nga viti 2023, Drejtoria ka përfituar fondin në vlerë prej 2,422,452.64 €.

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Shërbime Publike ka nënshkruar 13 kontrata të reja në vlerë prej 11,494,724.10 Euro. Mbi 10 projekte janë në fazën tenderuese, ndërsa, janë marr 19 vendime për fillimin e procedurave për implementimin e projekteve kapitale.

Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës

Është duke vazhduar përzgjedhja e personelit udhëheqës të shkollave. Përgjatë vitit 2024 është rishpallur konkursi për drejtorë në shkollat “Brigada 125” në Medvec dhe “22 Dëshmorët” në Randobravë.

Në muajin maj 2024 është mbajtur punëtori për “Planin zhvillimor të arsimit në Komunën e Prizrenit”.

Është hapur thirrja për digjitalizimin e sistemit të arsimit në DKA - është në fazën e prokurimit të shërbimeve, që pritet të fillohet në fillim të vitit shkollor.

Drejtoria e Shëndetësisë

Gjatë kësaj periudhe, nga kategoria e investimeve kapitale, ka përfunduar:

Furnizimi me aparatura mjekësore, Furnizimi me pajisje stomatologjike.

Në projektet kapitale që janë në vazhdim e sipër, hyjnë:

Ndërtimi i QKMF-së te ish kampi i KFOR-it,

Ndërtimi i QMF-së në fshatin Korishë.

Për projektet e tjera kapitale, përfshirë këtu ndërtimin e QMF-së në Lagjen e Trimave (Tusus), blerjen e mamografit, blerjen e autoambulancave, etj, janë iniciuar procedurat përkatëse dhe deri në përfundim të vitit pritet përfundimi i tyre.

Në kuadër të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, përveç projekteve që kanë të bëjnë me furnizimet me materiale të domosdoshme për punën e rregullt të QKMF-së, siç janë furnizimi me

reagenca, furnizimi me filma RTG, furnizimi me material higjienik, sanitar e barna, furnizimi me material administrativ, uniforma të punës, etj, vlen të ceken projektet:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për mbulimin e kërkesave dhe nevojës për staf shtesë të QKMF-së, kontratë e nënshkruar me Organizatën Caritas, në kuadër të së cilës përveç shërbimeve të rregullta shëndetësore, është i organizuar edhe kujdesi shtëpiak, projekt i cili ka qenë në vazhdim deri më 31 maj 2024.

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor

Rehabilitimi i kulmeve dhe korridoreve në objektet e banimit kolektiv

Është bërë përzgjedhja e objekteve ku do të bëhet rehabilitimi i kulmeve dhe korridoreve-tani është në fazën e tenderimit.

Sigurimi i kushteve optimale për banorët dhe përmirësimi i pamjes urbanistike të lagjeve ku janë banimet kolektive.

Hartimi i PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL (PZHK)

Është dokument shumë me rëndësi me të cilën DUPH-ja do të punoj një kohë të gjatë ku do të përcaktohen zonat e zhvillimit të pjesës urbane dhe rurale, me Ligjet, përkatësisht Udhëzimet Administrative që rregullojnë sferën e planifikimit dhe ka arritur deri te hartimi i profilit urban.

Hartimin e planit rregullues urban për zonën e veçantë - Parku i Biznesit

Plani rregullues urban për zonën e Veçantë-Parku i Biznisit ka kaluar fazën e tenderimit dhe ka arritur deri në shqyrtim publik.

Drejtoria e Inspektorateve

Shqyrtimi i lëndëve me problematikë të ndërtimit si: mbikëqyrja e projekteve, mbikëqyrja e objekteve, pjesëmarrja në komisione profesionale; Lirimi i hapësirave publike të cilat në mënyra të ndryshme shfrytëzohen nga bizneset dhe qytetarët, largimi i pengesave të ndryshme reklamave lëvizëse dhe statike nga këto hapësira, mbrojtjen nga dëmtimi i hapësirave publike;

Kyçje ilegale në rrjetin publik të ujësjellësit dhe kanalizimit;

Inspektimi i bizneseve që shfrytëzojnë hapësirat publike para lokaleve afariste me tavolina e karrige si dhe ekspozimin e mallrave dhe shitësit ambulantiv;

Procedurat e zhvilluara gjatë mbikëqyrjes inspektive të Sektorit të Ndërtimit

Procesverbale-339, Aktvendime-79, Ekzekutime-3, Kallzime penale-6

Njoftime, konstatime-10, Gjoha mandatorë në vlerë të përgjithshme-14,500 €

Gjobat mandatore të paguar gjatë këtij viti - 3,550 €.

Procedurat e zhvilluara gjatë mbikëqyrjes inspektive të Sektorit të Tregut

Janë hartuar procesverbale-545, Janë lëshuar aktvendime me urdhëresa-212, Janë dhënë pëlqime për ushtrimin e veprimtarisë afariste-115, Janë iniciuar në gjykatën kompetente (gjoha)-26, Janë asgjësuar produkte joushqimore, gjatë punës në terren, Janë asgjësuar produkte joushqimore me kërkesën e palës, vlera në - 7,446.63 €, Janë shqyrtuar ankesat- reklamacionet e konsumatorëve-

22, Plotësimi i kërkesave të gjykatës-2, Ndalimi i veprimtarisë afariste, përkohësisht, Gjoba nga Gjykata-15,350.00 €, Bashkëpunimi me Policinë, raste – 20.

Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri

Vendosja dhe mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Komunën e Prizrenit (janë hapur ofertat). Blerja e motorave special për Brigadën e Zjarrfikësve (janë hapur ofertat). Pajisje për brigadën e zjarrfikësve (janë hapur ofertat).Ndërtimi i mureve mbrojtëse nga rrëshqitjet e dheut.

Drejtoria e Administratës

Renovimi i objektit të zjarrfikësve. Furnizimi me gjeneratorë për nevojat e drejtorive Përfundimi i pjesës më të madhe të punimeve në terasat e Shtëpisë së Bardhë. Sinjalizimi dhe vendosja e laurave në parkingun te objekti i Administratës. Mbështetja e organizimeve të Epopeve të ndryshme. Furnizimi me dru dhe pelet i të gjitha objekteve nën mbikqyrjen e Drejtorisë së Administratës dhe Renovimi i objektit të batalionit të Zjarrfikësve.

Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit

Gjatë kësaj periudhe kemi pranuar 9856 kërkesa në kuadër të sektorit të gjeodezisë dhe kadastrit. Të përfunduara gjithsej 9.253 kërkesa, brenda afateve ligjore. Ndërsa 347 kërkesa janë në proces-shqyrtim, 164 janë refuzuar, 22 janë anuluar dhe 67 janë pezulluar. Në këtë periudhë nga shërbimet e lartë përmendura janë grumbulluar të hyra prej 177,810 euro - 35.56% e të hyrave kësaj drejtorie.

Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ndërtimi i shtëpisë për të moshuar (vazhdim i projektit), Ndërtimi i Qendrës për Punë Sociale 2 (QPS 2), Projekti Ndërtimi i banesave sociale në Lagjen Petrovë Kulla 4 (Vazhdim i projektit). Renovimi i banesave kolektive në Lagjen Petrovë Kulla 3 (Vazhdim i projektit). Ndërtimi i shtëpive për familjet me vështirësi ekonomike dhe rastet sociale – projekt që është miratuar, është ndarë parcela e cila gjendet në Lagjen e Trimave, në bashkëpunim me shoqatën “Jetimët e Ballkanit” do të bëhet ndërtimi i 50 shtëpive për këto kategori

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Shfrytëzimi racional i tokës bujqësore dhe mbrojtja nga ndërrimi i destinimit të pa planifikuar dhe aktivitetet tjera që kanë qëllime jo bujqësore; Hartimi dhe zbatimi i Programit për Investime kapitale/subvencione/shërbime; Organizimi i shërbimeve këshillimore dhe trajnimeve në aplikimin e mbrojtjes së integruar sipas veprimtarive prodhuese bujqësore; Furnizimi me pajisje të ndryshme bujqësore varësisht nga veprimtaria.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar gjithsejtë 128 kërkesa me shkrim nga lëmi të ndryshme, prej tyre 77 janë miratuar, 20 janë në proces, 5 janë hedhur poshtë, 9 janë refuzuar dhe 17 janë pezulluar.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ndërtimi i objekteve kulturore, rinore dhe sportive (kanë filluar punimet);

Ndërtimi i fushave sportive: Futboll, Volejboll dhe basketboll në fshatin Planejë; Renovimi i tërësishëm i sallës sportive në fshatin Medvec; Vendorsja e rrethojave në fushën e sportit në fshatin Kushnin; Ndërtimi i fushave sportive: Futboll, Volejboll dhe basketboll në fshatin Atmaxhë; Ndërtimi i fushave sportive: Futboll, Volejboll dhe basketboll në lagjen Bajram Curri; Ndërtimi i fushave sportive: Futboll, Volejboll dhe basketboll në fshatin Billushë; Ndërtimi i fushave sportive: Futboll, Volejboll dhe basketboll në fshatin Zhur.

Unë ju falënderoj që patët durim me dëgjuar, e shkurtova raportin por që s'kishte mundësi ma tepër me shkurtuar.

Ymer Berisha, Udhëheqës i Njësisë së Komunikimit me Publikun-Faleminderit, termi takim publik i kryetarit është kur e bën raportin e punëve dhe aktivitetet nga 1 janari deri më 31.06.2024. Kështu që unë po shoh dhe përfaqësues të fshatrave do të doja që eventualisht ta fokusojmë bashkëbisedimin me kryetarin dhe kabinetin, shumicën e drejtorëve e kemi këtu që do të marrin shënime sigurisht në dikasteret e tyre.

Do të jetë parë dikaster të caktuar, por ta evitojmë kërkesën për projekte që dëshironi të realizoni në të ardhmen, për arsye se me datën 18 korrik, kryetari i komunës bashkë me kabinetin do të jetë dhënë lokaliteti tuaja nëpër fshatra, rajone të ndryshme, edhe këtu në qytet dhe nëse eventualisht keni ndonjë propozim për projektet e ardhshme, do ishte mirë që të lani kur dalim dëgjime buxhetore.

Ndërsa tash nëse eventualisht ka filluar në projektet e tillë, nuk po shkon si duhet. Keni diçka me kryetarin ose me ndonjë drejtor?

Kryesisht të fokusohemi te raporti i punës 6 mujore, domethënë pastaj respektoni komunën edhe natyrën e komunikimit të tyre, natyrë ligjore të komunikimit në vend.

Qytetarët:

1-Resmije Krasniqi, kryetare e shoqatës humanitare me personat e hendikepuar mendor “Hader” në Prizren. E përsëritës zotëri kryetarin, drejtorët dhe gjithë të pranishmit. Shoqata jonë vepron që nga vitit 1999, sipas mundësive që keni të ndihmon shoqatës pasi që është në renovim pasi që do të ishte shumë mirë. Në shoqatë kemi 4 femra dhe 2 meshkuj në përkujdesje 24 orëshe, jemi në borxhe ju lus që të na ndihmoni neve si shoqatë.

Ymer Berisha-Ftojme që ta kesh 1 takim me drejtorin. Për specifikat dhe gjithçka që është brenda të drejtave ligjore. Unë besoj që kemi me barnat mirë mirë.

Resmija Krasniqi, ju faleminderit atëherë me padurim e presin ndihmën e drejtorit që e marrin parasysh për atë se me të vërtetë kemi borxhe me nuk kemi mundësi që të punojmë.

2-Marta Prekpalaj-kryetare e këshillit te fshatit Zym, Karashëngjergj, Krajk dhe Bregdri, kërkoi falje për vonesën por që u dashtë me i dërgua nxënësit në testin e arritshmerisë, kërkesa ime është kjo: për fshatin Bregdri, kemi problem me emërtimin e fshatit, ky problem na është paraqitur edhe gjatë regjistrimit të fundit të popullsisë. Për këtë problem kemi bërë kërkesë disa legjislativëve të Prizrenit, ju lus që ti shikoni ligjet dhe rregulloret dhe të merreni me këtë problem. Është ndarë buxhet për Bregdri, a është kanalizimi dhe trotuari përskaaj rrugës kryesore, pasi që vërtet është rrezik.

Përgjigje: Çel Lama drejtor i DSHP-së, për këto kërkesa lirisht mund të vijnë në zyrën time, çdo kërkesë e cila ka mundësi teknikisht të dhe financiarisht të zgjidhet, do të bëjmë zgjidhje.

Shani Tanaj, kryetari-Mazrek, Kojush, Planej, Milaj dhe Gorozhup-përshtëndetje kryetar Shaqir Totaj, përshtëndetje për ju Ymer Berisha, zotri Krasniqi, drejtor dhe kolegë, për kryetarin e kam këtë: ditëve të fundit në fshatrat e Hasit, po përballemi me mungesën të madhe të energjisë elektrike dhe të ujit, e di që nuk janë në kompetencë të komunës, por që mungesa e tyre po na vështirëson shumë punën tonë. Nëse keni mundësi që të keni një kontakt me këto dy kompani kishte me qenë shumë e udhës. Drejtor Çelë Lamaj, në falënderim për rregullimin e rrugës në fshatin Planej-Gorozhup, ajo është punuar shumë mirë dhe është përfunduar komplet.

3-Bujar Pulaj kryetar, Vërmicë, Shkozë, Dobrusht-Përshtëndetje kryetar, përshtëndetje drejtor dhe kolegë të nderuar unë pata dy fjalë rreth projekti për të cilin u informova që është në proces (udha e staneve). Nuk kemi nevojë më ne me debatu u pohoi që këtë vit të filloja punë dhe të bëjmë inaugurimin. Projektet që janë në proces, shpresojmë që do përfundojmë këtë vit janë projekte në tenderim, por është një çështje tjetër që duhet ta diskutojmë ose të bëjë një zgjidhje afatgjate. E di që është çështje e ministrisë çështja e liqenit, shfrytëzoj rastin ta falënderoj drejtoreshën e Ramize Shale-Sinani e cila ka qenë me stofin e zjarrfikësve, për një pjesë që ka mundur ta pastroj. Nuk kam qenë i informuar se sigurisht që do t'ju kisha bashkëngjitur edhe personalisht. Kish me qenë mirë me bashkëpunua me kryetarin e Kukësin, pasi që atyre u kanë dhënë dy pajisje donacion për pastrimin e liqenit.

Përgjegjës e kryetarit Shaqir Totaj, po të informoj që me atë kryetarin e mëparshëm të Kukësit, kemi pasur në plan për aplikim në një projekt bashkëpunimi ndërkuftar për fonde të bashkimit evropiane me temën pastrimi i liqenit. Mirëpo më pas ndodhi çka ndodhi dhe por rasti i parë që të na ipet, me siguri do të bëjmë pjesën tonë të punës e cila pritët prej neve, shpresojmë që mundemi me e realizu.

4-Imri Xhemaj, banor i lagjes Tusuz- unë i kam 3 kërkesa: rregullimi i rrugës, ndiçmi publik nuk kemi, Para3 muajve janë kohen ujësjellës a koni rrjedhje e kanë rregulluar, por kockat nuk i kanë rregulluar.

Përgjigje e kryetarit Shaqir Totaj-Të falënderoj që ke ardhur sot në takim me e dëgjuar raportin e punës, në fillim e thash që janë bërë do punë në Prizren por njëkohësisht e thash që nevojat e qytetarëve janë shumë më të mëdha se mundësitë tona që i kemi, me buxhetin që e kemi nuk

mundemi në të njëjtën kohë me i plotësi të gjitha nevojat, e kemi një listë të prioriteteve dhe ja fillojmë prej dhe në secilin fshat, në secilën rrugë do ti vijë rendi për me i plotësuar kërkesat tuaja.

Përgjigje-Çelë Lama, drejtor i DSHP-së, sa për sqarim si drejtor i pres të gjithë në takim qytetarët dhe mundohet me i sqaruar lidhur me kërkesat, me mundësitë që i kemi. Për ndriçimin publik flitet do të isha më i kënaqur sikur të kisha mundësinë që të bëjë ndriçimin në të gjitha lokalitetet e komunës, Tek tash është nënshkruar 1 kontratë, e cila ka filluar me riparime, kurse me instalimin e ri nuk do të jetë para muajit tetor, këto janë mundësitë teknike.

Sa i përket asaj grupet nëse je lajmëru ti për atë grup, nuk kam reagu, por nuk është e vërtetë që ka ardhur dikush sepse unë nuk e di se ku është gropë, në cilën pjesë të rrugës sonë nëse është lajmëruar dikush, reagimi është shumë i shpejt, kur t'ju them shumë shpejt brenda javës edhe në projekte edhe më të mëdha ne intervenojmë.

5-Shkelzen Shehi, kërkesat i kemi bërë i keni në komunë por se sa mundeni me i realizuar, kam një kërkesë dhe me siguri ju keni bashkëpunim me HidroRegjionin, po flas për fshatin. Kur ka rrjedhje të ujit, vijmë e sanojmë defektin, gropat nuk i rregullojmë, ka gropë që nuk është mbyllur që një vite e gjysmë, gropat janë në asfalt në rrugën kryesore, por ka edhe nëpër lagje, përgjigjen e marrim se do ti rregullojmë por që nuk i rregullojmë asnjëherë.

Përgjigje-Çelë Lama, drejtor i DSHP-së, një pyetje prej kujt furnizohemi me ujë dhe nëse jeni me Radoniqin, duhet t'ju drejtoheni atyre, ajo është ndërmarrje publike dhe nuk është kompetencë e komunës, normalisht ne bashkëpunojmë në memorandumet e caktuara. Mund ta bëjmë ndoshta një presion pozitiv në këtë drejtim. Ne e kemi të njëjtin problem me HidroRegjionin në komunën e Prizrenit që bën shumë hapje shpesh edhe pa leje dhe nuk e kthen gjendjen e cila duhet të kthehet, ashtu që e kishte me qenë mirë që ti drejtoheni rregullta kohë.

6-Herlonind Osmanollaj-kryetar i fshatrave Gjonaj dhe Tupec-Faleminderit për mundësinë e dhënë. I nderuar kryetar zoti Totaj, drejtor, kolege kryetarë. Po du me e pyet dhe drejtorin Çelë Lamaj se çka ka me u bë me rrugën kryesore në Gjonaj deri në dalje të fshatit Mazrrek, kam qenë në drejtorinë tuaj, kam pa që janë të parapara disa punime për fshatin Gjonaj, kur do të fillojnë.

Përgjigje-Çelë Lama, drejtor i DSHP-së, Ne kemi disa projekte në fshatin Gjonaj, normalisht që është edhe në procedurë projektimi dhe pjesa tjetër. Kurse sa i përket rrugës që përmendet në rritje se nuk është aq e vogël ajo gjatë vitit 2025 të implementojmë.

7-Mehreme Gërguri Krasniqi, pyetja ime është tek rruga "Shkronja", afër parkut të qytetit nuk ka shenjzime dhe paraqet një pengesë mjaft madhe të kompleksi FatGroup, për shkak se edhe për nxënësit që shkojnë në shkollë, por edhe qarkullimi i zakonshëm. Kur do të bëhet shpenzimi i rrugës.

Përgjigje-Çelë Lama, drejtor i DSHP-së, fatkeqësisht te ne presim me padurim si drejtor këtë kontratën shenjzime horizontale dhe vertikale, ka shkuar landa në OSH, e presin të na kthehet të na rezultoi pozitivisht me nënshkrimin e një kontrate. Unë mendoj që java 2 javët e para apo gjysma e muajit korrik do të na gjejnë me atë kontratë jo vetëm në atë pjesë, por ka shumë pjesë qytetit dhe dalje dhe hyrjet e qytetit që kanë problem edhe me shenjzime horizontale dhe vertikale.

8-Shkri Çuni kryetar i këshillit të fshatrave-Nashec dhe Grazhdanik , përshëndetje kryetar shëndeti për gjithë. Kërkesat normal që i kemi bërë edhe në asamble edhe si asambleist, por që sot ndoshta kam të drejt edhe me i lavdu si kryetar i fshatit, jo si asambleist. Si kryetar i fshatit Nashec, gjasë qeverisje për 2 vjet e gjysmë është arritur diku 1.300 metra kanalizim që është rregulluar.

Nuk ka përfunduar ende, po presim me përfundu. Kështu që ju falënderoj në emër të banorëve. Pastaj kanë fillu kanë fillu ndërtimi i rrugicave në fshatin Nshans. Edhe kjo është për me ju falënderua. Amo kontrata që 1 vjet është bërë por tash ka filluar. Kërkoj që të mos ndërpriten punimet edhe që të mbikëqyrë mbikëqyrësi dhe mund të jetë serioz mbikëqyrësit që ti kontrollojnë punimet se si janë duke u zhvillua. Edhe drejtori i shërbimeve publike ju falënderoj po ashtu në emër të banorëve Nashec dhe Grazhdanik për rregullimin e asfalit që ka qenë i prekur, që kanë kërkesa shumë herë këtu.

Po ashtu në drejtorinë e turizmit, në fakt duke filluar prej kryetarit, e falënderoj për një projekt shumë i gjorë në fakt, ish drejtoresha ka filluar këtë projekte, ishalla vazhdon ti drejtuar ty edhe kryen. Për ndërtimin e një parku turistik në Nashec një vlerë shumë e madhe kryetar e kom cekë ose asamblesë aty edhe këto në emër të banorëve falënderoj.

Po nuk po guxoj shumë falënderues Çelë, se mos po merrni mësysh punimet po na ndërpriten atje, po prap falënderimet janë emër si kryetar i bashkësisë lokale të fshatit banorëve, jo si asamble si asamblist përfshijnë tu fillu prej Gorozhupit e deri në Mazrek e fshatrat Nashec si Grazhdanik, kam hapësirë më të madhe, këto janë vetëm në cilësinë e kryetarit të fshatit Nashec dhe Grazhdanik.

Sa i përket fshatit Grazhdanik, këtu tash si kryetar i kësaj bashkësie që 2 muaj apo që sa janë mbajtur zgjedhjet nuk është investuar asnjë projekt pra nuk ka investim fare.

Ata kanë kërkesa, për kërkesat i kamë bërë që të mos shkoj më tek kërkesat po janë ato të paraqitën edhe në asamble dhe në edhe tash gjatë dëgjimeve publike. Kështu që sot vetëm ju falënderuar. A sa i përket qe se këto 2 kolegë për ujin? Që është problem në Nashec do të fillojë prej Gorozhupit, deri në fshatin Gjonaj, prej fshatit Vlashnje deri në Atmaxhë dhe lagjen Jeta e Re është problematike kryetar.

Dje e ceka edhe në kuvend, nuk kemi ujë që dy ditë më bënë, normal që është problem edhe i rrymës, unë këtu se na gjithnjë po shkojmë atë në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve. E di që ato janë kompani, po mendoj KEDS-i është i pavarur, por bashkëpunimi duhet me ken edhe me ne, nëse unë si asamblist nuk i bëj presion edhe Hidroregjionit Jugor edhe KEDS-it edhe Ekoregjionit, atëherë nuk e di roli jem, pse jam asambleja dhe ku duhet ngritur këto çështje? Po nuk po jap më vërejtje ma tepër se sot pata me ju lavdu.

Përgjigje-Çelë Lama, drejtor i DSHP-së, sa për informacion për fshatrat Grazhdanik për Grazhdanik, dje është dhënë urdhnesa dhe fillohet me kanalizim dhe kemi projektin për rrugë dhe kanalizime.

Përgjigje-Shaqir Totaj, kryetar i komunës, për me besu qe ke ardhë cilësi të kryetarit të bashkësisë lokale, nuk u dashtë me u ulë në vendin ku ulës si asamblesit, u dashtë me u ulë diku tjetër. Për ndryshe po kyçna, u përmend shpesh uji sa herë që përmendet uji, nuk ka nevojë me argumentu dhe me arsyetu sepse është çështje shumë e ndjeshme. Po besoni që edhe për kundër

insistimeve, angazhimeve tona, të ndërmarrjet publike, por edhe tek KEDS-i edhe vetë kemi shumë situata sfiduese. Por nuk po mundemi ma rrit ma tepër, kurse si përgjigje e përgjithshme për ata që thonë që nuk u investu në katun temën ose mahallë timen, unë po ju njoftoj që 96-97% e buxhet i vitit të kaluar është shpenzuar e pse nuk u investuan në atë katun ose mahallë, pse s'ka para ma tepër, më pas kishim investuar aty në periudhat e ardhshme, tentojmë me i përfshi edhe ato pjesë që deri më tash nuk janë përfshi.

9-Arsim Shala nga Hoça e Qytetit, përshëndetje kryetar që 2 vite kom problem me kyçjen në kanalizim, për shkak se drejtori Çelë, ka thënë që me e bë shpurjen këta, po pusët nuk ka. Unë që 2 vjet spo mund të bëjë zgjedhje. Zgjedhja e vetëme më ka mbetur tek ju

Përgjigje-Çelë Lama, drejtor i DSHP-së, po zotëriu ka një kërkesë në DSHP, që kërkon kyçjen në kanalizim. Para se me ardhë këtu në takim nuk mujta me e taku në zyre, por e takova në korridor dhe e orientova, u mundova t'ja sqaroj dhe lashtë zyrtarin tim ta takoj në zyrë dhe ta sqaron mirë. Duhet dihet që një rrugë 4 korsi të ndërpritet dhe prehet asfalti dhe të bëhet ajo kyçje nuk ka mundësi ligjore. Ligjet ndalojnë që ne akset tilla rrugore me i thanë zot ju qe duhesh me shku me marrë një pëlqen në ministrinë e infrastrukturës.

Kam dyshimet e mia qe veç do të sorollatet poshtë dhe lart, normalisht që ka mundësi që të bëhen edhe shpime nën asfalt, qe bëhen ato kyçe, unë i kërkova këtij zotëriut që duhet të orientohet te HidroRegjioni të merr zgjidhjen teknike. Ata dalin vendngjarjes ata janë ekspertë asaj pune dhe nëse duhet të bëhet dhe një pusët duhet dhe në bazë të asaj të bëhet një zgjidhje teknike, ne pastaj do ta pajisim me pëlqen.

Takimi ka përfunduar në orën: 11:30

Në këtë vegëz: <https://www.facebook.com/share/v/kxpsweQ3HCCHdQxv/>

Përgatiti:

Haziz Krasniqi

Nënshkrimi:

